



Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

01 Mars 2013

Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut ka konstatuar se UNMIK-u ka dështuar në hetimin e rrëmbimeve dhe vrasjeve të cilat kanë ndodhur par ardhjes së tij në Kosovë

Më 6 dhjetor 2012, gjatë seancës së tij të 56-të të mbajtur në Prishtinë, Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (Paneli) miratoi mendimin e tij të parë deri më sot lidhur me rrëmbimet dhe vrasjet të cilat kanë ndodhur pas vendosjes së UNMIK-ut në Kosovë, në qershor të vitit 1999. Në rastin e S.C. Paneli konstatoi se UNMIK-u kishte shkelur nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), me të cilën mbrohet e drejta për jetë sipas obligimit procedural, duke dështuar në zbatimin e hetimeve efikase për rrëmbimin dhe vrasjen e bashkëshortit dhe djalit të ankueses.

Detajet e rastit kanë të bëjnë me rrëmbimin e Ah.C. dhe An.C. nga pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Prizren në korrik të vitit 1999. Ankuesja theksoi se ajo menjëherë e kishte raportuar rrëmbimin e bashkëshortit dhe djalit të saj në Policinë e UNMIK-ut. Mirëpo, ajo asnjëherë nuk ishte kontaktuar më nga Policia e UNMIK-ut lidhur me ndërmarrjen e ndonjë hetimi. Mbetjet mortore të Ah.C. dhe An.C. u zbuluan në një varrezë masive nga hetues të Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish Jugosllavi në vitin 2000. Ata më pas u identifikuan dhe ju dorëzuan familjes në vitin 2003. Ankuesja u ankua se UNMIK-u dështoi në hetimin e incidentit dhe sjelljen e kryerësve të veprës para drejtësisë.

Në gjetjet e tij lidhur me nenin 2 të KEDNJ, Paneli mori parasysh obligimin e autoriteteve kompetente për të zbatuar hetim efektiv për vdekjet dhe zhdukjet e dyshimta, i paraparë në Ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Paneli gjeti se ky obligim ishte pjesë përbërëse e mandatit të UNMIK-ut, dhe prandaj ishte plotësisht i zbatueshëm në Kosovë. Paneli merr parasysh sfidat e shumta të vendosjes së UNMIK-ut si rrjedhojë e konfliktit. Mirëpo, përkundër këtyre vështirësive, Paneli vendosi që çdo rast të vlerësohet nëse UNMIK-u ndërmori të gjitha hapat e arsyeshëm dhe të zbatueshëm për të mësuar për fatin dhe vendndodhjen e personave të zhdukur, dhe për t'i sjellë kryerësit para drejtësisë.

Në rastin e S.C., Paneli gjeti se nuk ka pasur ndonjë indikacion se është ndërmarrë ndonjë aktivitet hetimor nga Policia e UNMIK-ut, përveç regjistrimit të detajeve personale për personat e zhdukur, që ishin marrë nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq. Paneli e pranon faktin se gjetja e mbetjeve mortore të Ah.C. dhe An.C. në vetvete ishte një e arritur e rëndësishme. Mirëpo, Paneli po ashtu theksoi se obligimi për zbatimin e hetimit nuk përfundoi me zbulimin e trupave, veçanërisht pasi ata treguan shenja të qarta të vdekjes së dhunshme. Prandaj, Paneli konkludoi se UNMIK-u kishte dështuar në kryerjen e një hetimi adekuat për rrëmbimin dhe vrasjen e Ah.C. dhe An.C., duke shkelur nenin 2 të KEDNJ.

Në këtë rast Paneli rekomandoi që UNMIK-u duhet të përpiqet, me të gjitha mjetet diplomatike që i ka në dispozicion, që të merr garanci nga EULEX-o dhe nga autoritetet e Kosovës se hetimi i rastit të Ah.C. dhe An.C. të kryhet në përputhje me kushtet e nenit 2. Paneli po ashtu rekomandoi që UNMIK-u t'i kërkojë falje publike ankueses dhe familjes së saj për dështimin e UNMIK-ut, dhe që UNMIK-u të konsiderojë pagimin e kompensimit adekuat ankueses për dëmin moral.

Paneli gjithashtu rekomandoi që UNMIK-u të ndërmerr hapat përkatës përmes subjekteve të degëve të tjera të KB-së që veprojnë në Kosovë, organeve vendore dhe OJQ-ve, për realizimin e një programi reparacioni të plotë dhe gjithëpërfshirës për viktimat e të gjitha komuniteteve të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut që ndodhën gjatë dhe si rrjedhojë e konfliktit në Kosovë.

Në Mendimin e tij Paneli më tej konkludoi që UNMIK-u mund të mbrojë pranë Kombeve të Bashkuara ndarjen e resurseve adekuate njerëzore dhe financiare për të siguruar përkrahjen e standardeve të të drejtave të njeriut në të gjitha kohërat nga KB-ja, duke përfshirë edhe kohën e administrimit të përkohshëm të një territori.

Përafërsisht 250 ankesa lidhur me vrasjet dhe zhdukjet që kanë ndodhur në Kosovë pas vendosjes së UNMIK-ut janë parashtruar pranë Panelit. Në dispozicion janë edhe mendime të tjera për bazueshmërinë e këtyre ankesave.

Ky mendim është në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

Kjo komunikatë për shtyp është dokument i përgatitur nga Sekretariati i Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut. Ky mendim nuk e obligon Panelin.

Për informacione të mëtejshme, luteni të kontaktoni z. Andrey Antonov, Zyrtar Ekzekutiv i Sekretariatit të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, e-mail: antonov@un.org, telefoni:

+381 (0) 38 504 604 lokali 5847. Vendime, mendime, dhe informacione të tjera për Panelin Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut mund të gjenden në www.unmikonline.org/hrap.